

BERTON SULEJMANI
KONTRIBUTI I STUDIUESVE TË HUAJ NGA UNIVERSITETET E
PERANDORISË SË AUSTRO-HUNGARISË PËR ZHVILLIMIN E
GJUHËS DHE SHKOLLËS SHQIPE¹

811.18:37

81(497)

811.18(091)

Abstrakti: Të dhënat arkeologjike dhe historike dëshmojnë se Gadishulli Ballkanik ka qenë i banuar nga popuj të ndryshëm edhe para ardhjes së fiseve i.e. (indoevropiane), që e kanë “indoevropianizuar” atë prej kohësh të hershme. Popullimi i këtij gadishulli është mundësuar edhe nga pozicioni i tij gjeografik si një urë ndërlidhëse midis Evropës dhe Azisë së Vogël. Profesor Norbert Jokli, një nga albanologët më të dëgjuar dhe më të shquar pati thënë: “**Pa shqipen, ballkanistika do të dukej si një përroskë**”. Ai e zotëronte shqipen më mirë se shumë shqiptarë dhe punoi për të me një zell të pashoq, për sa i përket zhvillimit të gjuhës sonë përballë rrymave të huaja, na la edhe këtë porosi: “**Mos shani gjuhën duke kujtuar se po e pastroni. Puna nuk është aq në fjalët e huaja sesa në shpirtin e gjuhës, të cilin duhet ta ruani nga çdo bastardim**”.

Fjalë kyçë: gjuhë shqipe, gjuhësi ballkanike, qendrat universitare të Perandorisë së Austro-Hungarisë, studiuesit e huaj, substratë.

ABSTRACT: CONTRIBUTION OF FOREIGN RESEARCHERS FROM UNIVERSITIES OF AUSTRO-HUNGARIAN EMPIRE IN THE FIELD OF DEVELOPMENT OF ALBANIAN LANGUAGE AND ALBANIAN SCHOOL

Archaeological and historical data prove that the Balkan Peninsula was inhabited by different nations even before the Indo-European tribes had arrived, and ‘Europeanised’ it from the early times. The population of this peninsula was enabled by its geographical position, which is a kind of a connecting bridge between Europe and Little Asia. Professor Norbert Jokli, one of the most famous Albanologists, once said: “**Without the Albanian language, Balkanistics would resemble a ravine.**” He mastered the Albanian language better than many Albanians, and worked for the language very zealously, and regarding the development of our language facing foreign spurt, he left the following message: “**Don’t chide the language thinking you are improving it. It is not about foreign words, but language’s spirit, which should be protected from any degeneration**”

Key words: Albanian language, Balkan language, University Centres of Austro -Hungarian Empire, Foreign researchers, substrate

Po e filloj këtë kumtesë shkencore me titull “Zhvillimi i gjuhësisë ballkanike nga gjuhëtarët që u shkolluan në qendrat universitare të Perandorisë së Austro-Hungarisë” me thënien e albanologut më të dëgjuar dhe më të shquar, Profesor Norbert Jokli i cili pati thënë: “**Pa shqipen, ballkanistika do të dukej si një përroskë**”. Ai e zotëronte shqipen më mirë se shumë shqiptarë dhe punoi për të me një zell të pashoq, për sa i përket zhvillimit të gjuhës sonë përballë rrymave të huaja, na la edhe këtë porosi: “**Mos**

¹ Kumtesë e mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare *Albanians and Hungarians – International Conference*, 26 – 28 maj 2014 në Albanian Studies Program at Elte, Budapest (Hungari).

shani gjuhën duke kujtar se po e pastroni. Puna nuk është aq në fjalët e huaja sesa në shpirtin e gjuhës, të cilin duhet ta ruani nga çdo bastardim”.

Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik në lashtësi. Të dhënët arkeologjike dhe historike dëshmojnë se Gadishulli Ballkanik ka qenë i banuar nga popuj të ndryshëm edhe para ardhjes së fiseve i.e. (indoevropiane), që e kanë “indoevropianizuar” atë prej kohësh të hershme. Popullimi i këtij gadishulli është mundësuar edhe nga pozicioni i tij gjeografik si një urë ndërlidhëse midis Evropës dhe Azisë së Vogël. Ky pozicion gjeografik u ka dhënë shkas gjithashtu dyndjeve të herëpashershme të popujve e fiseve të ndryshme, që, edhe kur janë asimiluar nga banorët më të hershëm, apo edhe kur kanë qëndruar për një kohë të kufizuar në Gadishullin Ballkanik, prapë kanë lënë herë më shumë e herë më pak gjurmë në gjuhët e folura në këtë gadishull. Natyrisht, këto gjurmë mund të hulumtohen e të përcaktohen me saktësi për periudha historike pak a shumë të njoitura, siç është p.sh. rasti i gjurmëve që ka lënë në bullgarishten e sotme gjuha e protobullgarëve, që u asimiluan nga popullsia e sllavizuar, apo siç është rasti i gjurmëve që kanë lënë keltët (fiset kelte u dyndën drejt Ballkanit aty nga fundi i shekullit III para erës së re dhe ndonjë fis i tyre u vendos aty ku lumi Sava derdhet në Danub) dhe gotët (është fjala për dyndjen e vizigotëve në shekullin IV të erës sonë, ata u larguan për në Itali në fillim të shekullit V të erës sonë¹.

Natyrisht, gjurmë herë më shumë e herë më pak të dukshme kanë lënë në gjuhët e Gadishullit Ballkanik edhe gjuhët e atyre popujve, të cilët në rrethana të caktuara historike erdhën dhe u asimiluan nga popuj të tjerë, që u mbishtresuan mbi ta. Këtu është fjala për të ashtuquajtura gjuhë substratë. Ky problem, sidomos për Ballkanin (dhe jo vetëm për këtë gadishull) paraqit një interes gjuhësor të shumanshëm (jo vetëm leksikor) dhe do të meritonte hulumtime dhe studime të posaçme të mëtejshme, që do të hidhnin më shumë drithë për gjuhët e folura në lehtësi në këtë gadishull. Këtu është fjala, në radhë të parë, për gjuhët e atyre popujve, që dëshmohen historikisht si banorë të vjetër të këtij gadishulli, siç ishin ilirët, trakasit, dakët, maqedonasit etj².

Po i themi disa fjalë rrëth togfjalëshave Gadishull Ballkanik dhe gjuhë ballkanike – nga pikëpamja gjeografike, Gadishulli Ballkanik përfshin vendet në jug të lumenjve Sava dhe Danub³, d.m.th. ish-Jugosllavinë, Bullgarinë, Shqipërinë dhe Greqinë. Emrin Ballkan ky gadishull e ka marrë relativisht vonë, aty nga mesi i shekullit XIX, pikërisht nga fjala gjegjëse turke Balkan, që do të thotë “malësi”. Në këtë rast kemi të bëjmë me përkthimin turqisht të emrit të vargmalit Stara Planina në Bullgarinë veriore. Për këtë dukuri, prof Shaban Demiraj thotë së emri i këtij vargmalit është shtrirë për të gjithë Gadishullin Ballkanik. Emërtimi i një gadishulli nëpërmjet të një vargmalit nuk është praktikë e panjohur; krahaso, p.sh., Gadishulli Apenin nga vargmalit i Apeneve, etj. Të kihet parasysh se vargmalet në Ballkan në kohë antike quhen *Haemus*.

Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik sot. Pasi Gadishulli Ballkanik me pozicionin e tij gjeografik si një urë ndërlidhëse midis Evropës dhe Azisë së vogël qysh nga kohët e hershme e deri në Mesjetën e vonë është bërë arenë dyndjesh të ndryshëm, gjë që ka bërë që nga kohë në kohë të ndryshojë edhe gjendja e tij gjuhësore. Natyrisht në ndryshimin e gjendjes gjuhësore të këtij gadishulli një rol të

¹ Shaban Demiraj, GJUHËSI BALLKANIKE, Logos – A, Shkup, 1994, f. 27.

² Po aty, f. 27 – 28.

³ Radoslav Katicic, Ancient languages of the Balkans. The Hague – Paris 1976, f. 11.

rëndësishëm ka luajtur edhe vetë evolucioni i gjuhëve, që janë folur këtu gjatë periudhave të ndryshme historike¹.

Si pasojë e këtyre dy faktorëve Gadishulli Ballkanik paraqitet sot si një trevë, ku brenda një sipërfaqeje relativisht të kufizuar fliten një numër jo i vogël gjuhësh të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe një gjuhë jo-i.e., turqishten. E po të krahasohet gjendja e sotme gjuhësore e këtij gadishulli me atë të periudhës antike, bie menjëherë në sy se përveç greqishtes (së re) dhe shqipes, që janë vazhdueset e greqishtes së vjetër, përkatesisht ilirishtes, gjuhët tjera janë zhvilluar këtu si pasojë e pushtimeve, përkatesisht e dyndjeve të popujve gjatë periudhash të ndryshme historike. Kështu p.sh. rumanishtja është përfstuar nëpërmjet romanizimit të dakëve të vjetër, bullgarishtja (e maqedonishtja) dhe serbokroatishqja dhe sllovenishtja janë zhvilluar pas dyndjeve sllave të shekujve VI–VII në Ballkan, kurse turqishtja është shfaqur këtu pas pushtimeve të perandorisë osmane (shekujt XIV–XV)².

Sot në Gadishullin Ballkanik fliten edhe gjuhë të tjera nga grupe më të vogla popullsish, si gjuha e romëve (e gabelëve), armenishtja etj. Prania e këtyre gjuhëve lidhet me lëvizjet paqësore të bartësve të tyre në periudha relativisht të vona.

Lidhur me gjendjen e sotme të Gadishullit Ballkanik do pasur parasysh se pothuaj në të gjitha trevat e këtij gadishulli ka “ishuj gjuhësorë” të ndryshëm, që janë pasojë e shpërnguljeve të masave pak a shumë të gjera popullsish nga një vend në tjetrin për arsyen ekonomike ose politike. Mjafton të përmendim këtu praninë e disa fshatrave greqishtfolës në Shqipërinë e Jugut (sipas vjetarit të R. së Shqipërisë (1990), f. 35, numri i greqishtfolësve në Shqipëri arrinte në 58.758), ose të disa fshatrave me origjinë sllave në pjesën lindore të Shqipërisë (sipas atij Vjetari, f. 35 numri i maqedonasve në Shqipëri arrinte në 4.700 vetë). Të kihet parasysh katundet shqipfolëse të Greqisë, të Serbisë, të Bullgarisë etj³.

Universitetet e Austro-Hungarisë dhe ndihmesa e studiuesve të këtyre qendrave për gjuhësinë ballkanike. Dukuritë e përbashkëta të gjuhëve ballkanike kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e shumë studiuesve. Ma sa dihet, i pari dijetar, që vuri në dukje disa nga këtë dukuri të përbashkëta, që gjuhëtari me origjinë sllovene B.J. Kopitar (filolog slloven, lindi në Repnje, Slloveni më 1780, vdiq në Vjenë më 1844. Është autor i së parës gramatikë shkencore të sllovenishtes). Në monografinë e tij të vitit 1829 *Albanische, walachische u. bulgarische Sprache*, duke u mbështetur jo vetëm në fjalët e përbashkëta, por edhe në “strukturën e njëjtë gramatikore”, Kopitari arriti në përfundimin e entuziazmuar: “Kështu, pra, deri në kohën e sotme në veri të Danubit në Bukovinë, Moldavi dhe Vllahi, Transilvani, Hungari, si edhe në anën tjetër të Danubit në Bullgarinë e mirëfilltë, pastaj në të gjithë vargun e Alpeve të Ballkanit, në kuptimin e vjetër më të gjerë të këtij vargmalit, nga njëri det në tjetrin, në vargmalet e Maqedonisë, në Pind dhe përmes Shqipërisë sundon vetëm një formë gjuhësore, por me tri lloje lënde gjuhësore (nga të cilat njëra është vendase, ndërsa dy të tjera kanë ardhur nga perëndimi dhe nga lindja⁴. Dihet se në atë kohë (dhe deri vonë) maqedonishtja nuk trajtohej si gjuhë më vete, por si një dialekt (perëndimor) i bullgarishtes (Shih Sh. Demiraj, 1994, I/1). E themi këtë sepse Kopitari merr në vështrim rumanishten (vllahishten), bullgarishten dhe shqipen. E kjo është e shpjegueshme, po të kihet parasysh se ai në monografinë e tij është ndalur më fort në prapavendosjen e nyjës shquese, dukuri kjo që është shfaqur pikërisht në këto gjuhë.

Një gjë tjetër, që bie në sy në përfundimin e Kopitarit, është mendimi i tij se në të tria këto gjuhë “sundon vetëm një formë gjuhësore, por me tri lloje lënde gjuhësore”. Sado që në këtë mendim ka njëfarë teprie,

¹ Sh. Demiraj, GJUHËSI BALLKANIKE, Logos – A, Shkup, 1994, f. 49.

² Po aty.

³ Po aty, f. 50.

⁴ Shaban Demiraj, GJUHËSI BALLKANIKE, Logos – A, Shkup, 1994, f. 15.

sidomos kur është fjala për bullgarishten, e cila mbetet gjithnjë një gjuhë sllave jugore, prapë nuk mund të mos mbahet parasysh fakti që bullgarishtja dhe (sidomos) maqedonishtja i janë nënshtruar procesit të ballkanizmit, që i ka bërë ato të dallohen gjithnjë e m shumë nga gjuhët e tjera sllave, përfshirë këtu edhe serbokroatishtja, vëren prof. Shaban Demiraj.

Pasi treguam se studimet e gjuhësë ballkanike i pari i vuri re Kopitari, po i përmendim, sipërfaqësisht, ballkanizmat ose ndryshe thënë disa nga dukuritë e përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit. Ato janë: 1. Formimi i kohës së ardhme me anë të foljes “dua” në serbishte, në bullgarishte, në rumanishte, në greqishte të re dhe në shqipe. 2. Zhdukja e paskajores dhe zëvendësimi i saj me lidhoren në bullgarishte, në greqishte të re, në shqipe dhe në rumanishte e pjesërisht edhe në serbishte. 3. Përdorimi i së njëjtës formë për gjinoren dhe dhanoren në bullgarishte, në rumanishte dhe në shqipe. 4. Prapavendosja e nyjës shquese në bullgarishte, në rumanishte dhe në shqipe. 5. Prania e zanores ë në bullgarishte, në rumanishte dhe në shqipe. 6. Rimarrja e kundrinave nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vtorë në bullgarishte, në rumanishte, në greqishte të re dhe në shqipe. 7. Formimi i numërorëve 11 – 19 nëpërmjet një parafjale të ndërfutur midis numërorit të vogël dhe numërorit dhjetë në rumanishte, në shqipe dhe në gjuhët sllave¹.

A janë shqiptarët autoktonë apo ardhës? Ndihmesa e dijetarëve të Austro-Hungarisë për këtë çështje. Me problemin e autoktonisë së shqiptarëve, me çështjen a janë këta vendas në viset që banojnë sot apo janë të ardhur në një epokë historike, ka lidhje të ngushtë problemi i burimit të tyre dhe të gjuhës së tyre. Në qoftë se ata janë autoktonë, meqë në Shqipëri kanë jetuar në kohë të vjetër fise ilire, del si rrjedhim se ata janë stërnipat e këtyre fiseve dhe shqipja është një nga dialektet e vjetra ilire. E në qoftë se vërtetohet që janë të ardhur, treten mundësitetë e ilirizimit të tyre². Prandaj ka të drejtë Norbert Jokli, më i shquari albanolog austriak, kur çështjen e autoktonisë e quan problem themelor të prehistorisë së shqipes. Për prejardhjen e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre janë parashtruar hipoteza të ndryshme, nga të cilat vleinjë të përmenden ato që i paraqesin këta si pasardhës të ilirëve, apo të një ose disa fiseve ilire, përkatësisht si pasardhës së trakasve apo të dakomizëve. Një hipotezë mjaft e përhapur ka qenë edhe ajo e prejardhjes pellazgjike të shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre. Nuk kanë munguar edhe tezat tjera³.

Edhe pse hipotezen pellazgjike, siç e dimë, ka gjetur përkrahje sidomos ndër autorët arbëreshë dhe shqiptarë të shek.XIX, si: De Rada, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Jani Vretoja etj., çështja e pellazgëve nuk është aspak e qartë. Sipas autorëve të vjetër grekë, ata ishin një popull i vjetër me banim në treva të ndryshme të Greqisë. Edhe përkatësia e tyre i.e. nuk është e qartë⁴.

Hipoteza më e përhapur për prejardhjen e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre ka qenë dhe është ajo e origjinës ilire. Ndër ata që kanë mbrojtur këtë tezë, mund të përmenden: Thunman-i (Thunmann), Leake-u, Xylander-i, Hahn-i, Miklisich-i, Meyer-i, Kreçmer-i, Pederseni, Cimochovki, Çabej, Pisani, Ölbrg-u, Katiçiçi, Domi, Desnickaja, Ismajli, Demiraj, Ajeti, Mansaku etj. Argumenti kryesor, që kanë paraqitur mbrojtësit e prejardhjes ilire të shqiptarëve, ka qenë i karakterit historik-gjeografik. Argumentin me karakter historik-gjeografik e gjemjë të shprehur për herë të parë te Thunman-i i cili thotë: “Në historinë e tyre unë nuk kam gjetur asnjë gjurmë të ndonjë shtegtimi të tyre të mëvonshëm; gjuha e tyre ka dhënë

¹ Fr. Miklosich, Die slavischen Elemente im Rumunischen (Në: Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, Philos. – histor. Classe VII) Wien, 1861 (referencë e marrë nga Shaban Demiraj, GJUHËSI BALLKANIKE, Logos – A, Shkup, 1994)

² Eqrem Çabej, STUDIME GJUHËSORE III, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 37.

³ Shaban Demiraj, Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të Gjuhës shqipe, SHB “Shkenca”, Tiranë, 1999, f. 71.

⁴ Po aty, f. 72.

dëshmi të tilla nga fatet e popullit, që unë në këtë nuk mund të mos njoh fqinjët e stërmocëm të grekëve dhe nënshtetasit e Romës së vjetër. Dhe të dyja këto më tregojnë ilirët e vjetër”¹.

Një arsyetim të ngjashëm e gjemjë edhe te Hahn-i: “... duke qenë se shqiptarët nuk janë sllavë dhe me asnjë popull të njohur nuk kanë afri, duke qenë se burimet vërtetë të pakta, përvèç shtegtitim sllav, nuk bëjnë fjalë për asnjë shtegtim tjetër, që të ishte mjaft i rëndësishëm për të krijuar një popull të madh, atëherë njeriu ka të drejtë të pranojë që shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e banorëve të lashtë parasllavë të vendit”. Ai shton: “... prandaj neve na duket shumë më i natyrshëm pranimi që stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm qysh në kohën e romakëve dhe të grekëve zinin vendbanimin e sotëm të tyre dhe që zakonet e tyre të përbashkëta me popujt fqinjë i kanë ruajtur në mënyrë më të pastër dhe më besnikë sesa fqinjët e tyre”².

Një vëmendje të veçantë meriton teza e Norbert Joklit në këtë çështje. Ky dijetar edhe në lidhje me problemin e autoktonisë mban një qëndrim të mesëm. Ai në pajtim me Hahnin e kundër Parvenit e Vajgandit (Weigand) është i bindur se shqiptarët janë autoktonë, veçse këtë autoktoni e vështron në një kuptim më vete. Duke u nisur nga mendimi se toponomastika shqiptare dëshmon kundër pranisë së lashtë të shqiptarëve në atdheun e tyre të sotëm dhe që terminologjia e peshkatarisë është në pjesën më të madhe e huaj, ai përfundon që vendbanimi i dikurshëm i shqiptarëve nuk është po ai që kanë ata sot, brigjet e Adriatikut në kohë të para nuk kanë bërë pjesë në këtë djep të moçëm të tyre. Djepi i popullit shqiptar për këtë dijetar është Dardania, një vend që sipas mendimit të tij u përgjigjet këtyre kushteve: është një trevë ku piqeshin ilirishtja me trakishten, trevë brenda sferës së greqishtes, po jo dhe fare jashtë sferës së kësaj gjuhe. Nga ato anë shqiptarët u shkulën për në atdheun e sotëm në kohën e vonë latine, por para ardhjes së sllavëve në Shqipëri: “Sllavët me dyndjet e tyre në viset bregdetare afër Buenës gjetën aty një popullsi shqiptare”. këtij mendimi i mbahet në kohën e fundit edhe Bariçi. Me tezën e Joklit bashkohet gjer diku edhe Petar Skoku. Duke u nisur nga të tjera pikëpamje Miss Edith Durham qe shprehur që më 1923 që Dardania si një vend malor ka qenë banuar vazhdimisht prej shqiptarëve³.

Një analizë krahasimtare e toponomastikës në vështrimin që u ravijëzua këtu tregon se trajtat e tanishme të këtyre vendeve shpjegohen me anën e fonetikës së shqipes. Pra në vend që të shërbejnë si një dokument kundër autoktonisë, dëshmojnë bash se në këto anë elementi shqiptar banon paprerë të paktën që prej kohës greko-romake. Vetëm me anën e shqipes shpjegohet zhvillimi fonetik në këto emra topike që dihet prej periudhës antike: Naissus – Nish; Scardus mons – Sharr; Scupi – Shkup; Scodra – Shkodër, Lissus – Lesh; Drivastum – Drisht; Dyrrachium – Durrës; Candavia – Kunavja, e emrat e lumenjve Drinus – Dri, Drin; Barbanna – Buena; Mathis – Mat; Isamus fluvius – Ishm. Kështu te Scardus – Sharr mungon ndërmjetësia e sllavishtes, që shihet përkundrazi te Scardona në Dalmaci, sot Skradin, me ndërrimin Skard; Skrad, karakteristikë për sllavishten. Edhe te Scodra – Shkodër e te emri i Rogami-t nuk mungon kontinuiteti i shqipes, sikundër mendon N. Jokli⁴.

Ndihmesa e Frantishek (Franz) Miklošićit në fushën e albanologjisë dhe ballkanologjisë. Duke qenë talent dhe falë veprimtarisë së tij shkencore, Miklošići shumë shejt u shqua si një gjuhëtar i talentuar. Që nga viti 1848 ishte profesor i filologjisë sllave në universitetin e Vjenës, por, njëkohësisht ishte edhe anëtar i Akademisë së shkencave të Austrisë (1851). Në kontekst ballkanik, Miklošići, duke qenë gjuhëtar me interesa shkencore të gjera, botoi veprat e tij të shquara dhe të vëllimshme në fushën e

¹ Po aty, f. 73.

² Po aty, f. 73-74.

³ Eqrem Çabej, STUDIME GJUHËSORE III, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 39.

⁴ Po aty, f. 40 – 41.

filologjisë sllave, si: “Gramatikë krahasuese e gjuhëve sllave” (në katër vëllime, 1852 – 1875). Kjo vepër me katër vëllime ka bërë që ai ta meritojë titullin e themeluesit të filologjisë sllave moderne.

Botimet e tij të shumta dëshmojnë qartë se ai ka dhënë ndihmesa të çmuara edhe në filologjinë romane, në ballkanologji, albanologji etj. Por në këtë punim jemi fokusuar më shumë për kontributin e ndihmesën e tij kryesore në fushën e ballkanologjisë dhe albanologjisë.

Miklosiqi u ka kushtuar një vëmendje të posaçme edhe dukurive gjuhësore të përbashkëta të gjuhë ballkanike në përgjithësi dhe elementit të vjetër të përbashkët të shqipes dhe të rumanishtes. Këto çështje ai i ka shqyrtuar sidomos në studimin e tij “Die slavischen Elemente im Rumunischen” të vitit 1860 (f. 6 – 10)¹. Është e vërtetë se probleme të tillë janë trajtuar më parë edhe nga gjuhëtari tjetër sloven, J. Kopitari, por Miklosiqi i ka shqyrtuar ato në një mënyrë më të plotë dhe më të thellë. Studimi i Miklosiqit përfaqëson përpjekjen e parë serioze për t'i shpjeguar këto probleme të vështira, që kanë tërhequr gjithnjë e më shumë vëmendjen e gjuhëtarëve të vendeve të ndryshme. Për këtë arsyе ai mund të konsiderohet me të drejtë si një ndër themeluesit e ballkanologjisë².

Norbert Jokli (1877 – 1942) – albanologu më i shquar nga periudha e Perandorisë së Austro-Hungarisë. E shoh të arsyeshme që t'i themi disa fjalë edhe për gjuhëtarët e huaj, përkatësish albanologët të cilët u shkolluan në qendrat austro-hungareze dhe që punuan pakursyer asgjë për të vënë në dritë disa çështje thelbësore të shqipes e me këtë edhe të shqiptarëve.

Sa herë që flitet për albanologjinë, N. Jokli radhitet ndër yjet më të ndritur, krahas Holger Pedersenit dhe Gustav Majerit. Ky burrë që doli nga shkolla gjuhësore austriake, ka gjurmuar me ngulm gati të gjitha dukuritë dhe çështjet që kanë të bëjnë me sistemin e shqipes, si ato që lidhen me gjendjen e sotme, ashtu edhe ato që kanë të bëjnë me fazat më të hershme të saj. Edhe në qofte së në mendimet dhe pikëpamjet e veta N. Jokli nuk na del gjithmonë aq novator, prapëseprapë bie në sy menjëherë që pothuajse nuk ka rrugë a metodë (qoftë edhe të ravijëzuar në mënyrë krejt të turbullt e embrionale nga ndonjë gjuhëtar tjetër, por që në vetvete është novatore), të cilën ai të mos e ketë rrokur dhe zbatuar me konsekuençë e me përpikëri të pazakontë në lëmin e studimeve albanologjike³.

Gjuhëtar ynë, kolosi i gjuhësisë shqiptare, Eqrem Çabej, ish-student i Joklit, na thotë se ai ishte i thjeshtë, siç ishte edhe ai vetë⁴. Duke qenë referent dhe drejtues i punës për përgatitjen e katalogëve shkencorë të bibliotekës për dhjetëra vjet me radhe (1923 – 1938) ai ndoqi ndër të tjera sistematikisht edhe tërë filologjinë shqiptare⁵. Në vitin 1937, me rastin e njëzetepesëvjetorit të shpalljes së pavarsisë së Shqipërisë, Jokli vizitoi për herë të parë dhe të fundit vendin tonë (Shqipërinë) ku iu dhe edhe “Urdhri i Sknderbeut”. Me këtë rast ai mbajti referatin shkencor “Shkenca evropiane dhe gjuha shqipe”, në të cilin parashtron arsyet për së interesohet gjuhësia evropiane për gjuhë shqipe.

Norbert Jokli filloi të merret me shqipen me shtysën e V. Jagićit, i cili kishte vënë re se me vdekjen e G. Majerit dhe me tërheqjen e Pedersenit, në këtë fushë ishte krijuar një zbrazëti e ndjeshme⁶. Por, këtu nuk duhet harruar ndihmën e Dr. Gjergj Pekmezit, nga i cili kishte ndjekur një kurs të lartë të gjuhëve orientale dhe me zillin që e karakterizonte duke studiuar vetë, madje edhe duke u mbështetur në dy fjalorët e porsabotuar, atë të Kristoforidhit e të Bashkimit, por edhe duke kërkuar dhe ndihmën e

¹ Shaban Demiraj, GJUHA SHQIPE, Probleme dhe disa figura të shquara të saj, Globus R, Tiranë, 2003, f. 141.

² Po aty.

³ Ali Dhrimo, Gjuha jonë 3-4, 1992, f. 86.

⁴ Eqrem Çabej, *Das albanologische Werk Norbert Jokls*, në “Aktien des internacionalen albanologischen Kolloquiums”, Innsbruck, f. 3.

⁵ Ali Dhrimo, Gjuha jonë 3-4, 1992, f. 87.

⁶ Po aty, f. 88.

studentëve shqiptarë të Vjenës, Jokli arriti të shkruajë e të flasë lirisht një shqipe që i përgjigjej gegërishtes së mesme, ose të folmes së Elbasanit. Kur e përmendëm gjuhëtarin shqiptar, Dr. Gjergj Pekmezin, është e udhës t'i tregojmë, sipërfaqësish, dhe disa të dhëna historike të cilat lidhen me periudhën e Perandorisë Austro-Hungareze.

Jokli u mor me të gjitha aspektet e sistemit të shqipes. Ai iu drejtua të dhënave kulturore, etnografike, historike, gjeografike e gjuhësore të popullit shqiptar, prandaj prof. Eqrem Çabej i quan me të drejtë studimet e tij “*Studime të Shqipërisë*¹”. Por, edhe në qoftë se vepra e tij mbeti e papërfunduar, prapëseprapë ajo që na ka lënë Jokli, përbën një të tërë të mbyllur e shumë të rëndësishme. Është fjala për tri vepra të mëvetësishme dhe mbi dyzet artikuj të gjatë, të cilët duhet kundruar si punë përgatitore për fjalorin etimologjik dhe gramatikën e krahasuar historike. Ato shtrihen në një periudhë të gjatë kohore gati 30 vjeçare, që nga 1911 dhe deri në fund të jetës. Shkrimi i tij i parë është “*Studime rrëth etimologjisë dhe fjalëformimit të shqipes*”. Më 1917 botoi “*Historia e gjuhësisë indoevropiane që nga themelimi i saj prej F. Bopit*” ku parashtroi punën e bërë për studimin e shqipes deri në atë kohë, shoqëruar me qëndrime kritike. Kryevepra e Joklit mbetet pa dyshim “*Gjurmime gjuhësore kulturorohistorike nga lëmi i shqipes*” (1923), një vepër prej 367 faqesh ku përpunohet një pjesë e mirë leksikore e shqipes, sipas parimit “fjalët dhe sendet”. Disa shkrime të Joklit janë botuar pas vdekjes së tij, si p.sh.: “*Marrëdhëniet e afrisë së shqipes me gjuhët e tjera indoevropiane*”, “*Vërejtje gjuhësore për historinë e vjetër të shqiptarëve*”, “*Fjala shqipe si dëshmi e historisë kulturore shqiptare*”, “*Materiale të rumanishtes nga Shqipëria*” etj².

Jokli i mor me pyetjen se nga cila gjuhë jogreke e Ballkanit buron shqipja, cilët janë, pra, të parët e shqiptarëve? Duke rrokur këtu idenë e hedhur tashmë prej H.J. Tunmanit më 1774 se në formimin e kombit shqiptar krahas elementit ilir vërehet edhe një komponent trak, pikëpamje që e mbështet edhe Paçi (i cili flet për gjurmë trake në Adriatik) dhe Nopçë³ (i cili mendon se një element trak erdhi e u mbulua në këto anë nga elementi ilir), Jokli e mbështetë këtë qëndrim me argumente fonetike, morfollogjike dhe leksikore. Ai hodhi këtu tezën e vet të sintezës, d.m.th. që trashëgimia gjuhësore e këtyre dy popujve të lashtë të Ballkanit lidhet shumë ngushtë me gjuhën shqipe. Ndërkaq ai mënjanon shprehimisht termin “gjuhë iliro-trake” ose “trako-ilire”⁴.

Një çështje tjetër madhore, është çështja e ngulimeve të hershme të shqiptarëve, e trevës ku u formua gjuha shqipe brenda Gadishullit Ballkanik. Ai arrin në përfundim se kjo duhet të jetë Dardania, një trevë që mundësonte fqinjësinë e të parëve të shqiptarëve me fiset balte. Duhet thënë se mendimi më i përhapur dhe më i pranueshëm nga dija e sotme për këtë çështje është që Dardania është vetëm një pjesë e djepit të hershëm të shqiptarëve dhe jo treva, ku u formua ky popull dhe gjuha e tij. Megjithatë, më vonë, Jokli është ndër të parët që u ngritën kundër pikëpamjes së Vajgandit, Filipides e Selishçevit. Sipas tij, fjalët si Drin e Mat kanë qenë pa ndërprerje në gojën e shqiptarëve dhe vetëm shqipja mund t'u jepte trajtën që kanë sot.

Jo më pak është marrë Jokli me problemet e huazimit e të kalkimit në gjuhën shqipe në kontekstin ballkanik. Duke qenë i bindur se Majeri e kishte ekzagjeruar shumë rëndësinë e përpjesëtinim e huazimeve në shqipe. Për t'i mbështetur pikëpamjet e veta, shkroi artikullin “*Studime rrëth etimologjisë dhe fjalëformimit të shqipes*” në të cilin trajtimi i fondit të trashëguar zë 101 faqe derisa i huazimeve 13

¹ Eqrem Çabej, *Das albanologische Werk Norbert Jokls*, në “Aktien des internacionalen albanologischen Kolloquiums”, Innsbruck, f. 20.

² Ali Dhrimo, *art. i përmendor*, f. 89.

³ Franc Nopçë etnograf i shqar hungarez i cili i ndihmoi shumë Joklit për studimin e fjalëve shqipe dhe etimologjisë së tyre, për të cilën na del novator i vërtetë. Nga kjo fushë mund të përmendim shkrimet: “*Rreth historisë së gjuhësisë shqiptare*”, “*Rreth fondit të trashëguar leksikor në gjuhën shqipe*”, “*Rreth prehistorisë së shqiptarëve dhe të shqipes*”, “*Mbi elementet e trashëguara indoevropiane në gjuhën shqipe*”.

⁴ Ali Dhrimo, *art. i përmendor*, f. 91.

faqe. Andaj ky punim së bashku me atë të Pedersenit përbën hapin më të rëndësishëm pas fjalorit të Gustav Majerit.

Në kontekstin ballkanik ai ka ndjekur huazimet e shqipes nga greqishtja e vjetër, e mesme dhe e re. Një gjë kolosale, që duhet ta përmendim është që atij nuk i ka shpëtar pa vënë re edhe aspekti i kundërt, hetimi i elementit të shqipes të huazuar nga greqishtja, deri edhe në shprehje të tillë, si *dielli perëndon*. Një ndihmesë të shquar ka dhënë Jokli për ngushtimin e elementit që ishte menduar se shqipja e kishte huazuar prej latinishtes. Krasa huazimeve të hershme latine dhe të mëvonshme romane (italiane), Jokli hetoi një shkallë të ndërmjetme që lidhet me dalmatishten. Madje, edhe në latinishte, Jokli, ka hetuar elemente të shqipes.

Të dhëna të reja ka sjellë Jokli edhe lidhur me elementet ballkano- gjermanike të shqipes dhe për marrëdhënet sllavo-shqiptare të huazimit. Edhe në këto të fundit ai ka vënë ë dukje si rolin marrës, ashtu edhe atë dhënës të shqipes, sidomos ndaj të folmeve fqinje të saj. Bien në sy veçanërisht nga pikëpamja e metodës gjurmimet e tij për marrëdhënet shqiptaro-rumune të huazimit. As elementet hungareze që kanë hyrë në shqipe përmes serbokroatishtes, nuk i kanë shpëtar syrit të këtij studiuesi¹.

Nga këto tematika, pra të këtyre fushave, mund të përmendim shkrimet: “Maqedonishtja e vjetër-greqishtja-shqipja”, “Studime shqiptaro-greke”, “Përkime shqiptaro-iraniane”, “Keltët dhe shqiptarët”, “Elementet magjare (kupto: hungareze – B.S.) në leksikun e shqipes”, “Studime rrith latinishtes ballkanike”, “Mbi elementet latine të leksikut të shqipes”, “Kontributet albanologjike për njohjen e latinishtes ballkanike”, “Elementet gjermanike të Ballkanit dhe elemente gjermanike në gjuhën shqipe”, “Stratigrafia e fjalëve sllave dhe studimet në lëmin e huazimeve të shqipes, “Sllavët dhe shqiptarët”.

Kontributi i Austro-Hungarisë për gjuhën dhe shkollën shqipe. Në një raport, që guvernatori i Dalmacisë, David, i dërgonte Vjenës, më 11 tetor 1901, i vinte në dijeni eprorët e tij se shuma prej 130 koronave të cilat ishin destinuar për drejtuesin për drejtuesin e kurseve të gjuhës shqipe, Pashkë Bardhin, i ishin dërguar Drejtorisë së Institutit Pedagogjik në Borgo Erizzo.² Po në atë vit, 1901, Austro-Hungaria kishte hapur një shkollë në Bizë.³

Në vazhdën e interesimit të qeverisë së Vjenës për çështjen shqiptare, në vitin 1900, gjuhëtar shqiptar, Dr. Gjergj Pekmezi⁴ u dërgua nga Akademia e Shkencave në Vjenë për qëllime hulumtimi në Elbasan⁵. Dërgimi i tij u bë me qëllim që të siguroheshin sa më tepër informacione për Shqipërinë dhe shqiptarët. Nga ana tjetër, edhe ndonjë shkollë shqipe, që kishte mundur ta vazhdonte veprimtarinë e saj, gjatë viteve të para të shek.XX, përballej me vështirësi të mëdha financiare. Kështu shkollat shqipe e djemve 144 dhe e vajzave 145 në Korçë, ndonëse vazhdonin funksionimin e tyre, veç të tjerave, kishin mjaft probleme financiare⁶.

Për të plotësuar nevojat financiare, në rritje të dy shkollave shqipe të Korçës, atdhetarët shqiptarë iu drejtuan për ndihmë qeverisë austro-hungareze, e cila ishte përkrahëse e Lëvizjes Arsimore Shqiptare,

¹ Ali Dhrimo, *art. i përmendur*, f. 92.

² AIH, Vj. 10-56. Raport guvernorit të Dalmacisë, David, për në Vjenë (s'tuhet se kujt i drejtohet rapporti), më 11 tetor 1901.

³ P. Donat Kurti, O.F.M. 1935, Vepra kulturale e elementit katolik në Shqypni, Shkodër, Botimi i “Hyllit të Dritës”.

⁴ Gjergji Pekmezi lindi më 1872 në Tushemisht. U diplomua për filozofji dhe gjuhësi në Universitetin e Vjenës. Për dhjetë vjet (1928-1938) ligjëroi mësimet e gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës. Ai është autor i disa librave për mësimin dhe leximin e gjuhës shqipe. Vepra më e rëndësishme e tij është “Gramatika e gjuhës shqipe”, e botuar më 1908, e cila njëkohësisht është edhe gramatikë historike e mbështetur në gjuhësinë krasauese historike, e një niveli të lartë shkencor. Është bashkautor i një bibliografie shqiptare të botuar më 1909.

⁵ Fehari Ramadani, Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare 1900 – 1912, Tetovë, 2010, f. 44.

⁶ Po aty.

gjatë asaj kohe. Ndonëse Shqipëria Jugore ishte jashtë sferës së Kultusprotektoratit austro hungarez, Vjena nëpërmjet konsullatave dhe nënkonkonsullatave të saj në Shqipëri, ndiqte hap pas hapi zhvillimin e arsimit kombëtar edhe në atë pjesë të Shqipërisë. Veçanërisht shkollat shqipe të Korçës u bënë shpejt objekt i vëzhgimit dhe interesimit për diplomatët austro-hungarez të vilajetit të Manastirit.¹

Sipas një raporti që konsullata austro-hugareze, në Manastir, i dërgonte Vjenës, më 14 janar 1902, jepej edhe një shkresë-falënderimi, që Gjergj Qiriazi, ia drejtonte qeverisë austro-austro-hungareze që kjo e fundit i kishte dërguar shkollës së vajzave në Korçë. Ai e falënderonte përzemërsisht qeverinë perandorake dhe mbretërore për bamirësinë që ajo kishte treguar për shkollën në fjalë, sepse për atë “përkrahje dhe simpati” shkolla nuk do ta kishte pasur “një përparim të tillë, që ajo ka sot”. Në janar të vitit 1902, mësimet atje i ndiqnin edhe 9 nxënëse konviktore, prej të cilave vetë tre i mbulonin vetë shpenzimet e tyre. Katër konviktore nuk ishin nga rrëthi i Korçës, madje dy prej tyre ishin bonjake nga Ballkameni (kazaja e Follorinës), të cilave ishte e nevojshme, veç tjerave, t'u sigurohej dhe veshmbathja. Një konviktore tjetër ishte nga Negovani (kazaja e Follorinës) dhe një nga Berati. Në atë kohë shkollën e ndiqnin edhe 41 vajza të tjera, që nuk banonin në konvikt.²

Literatura e shfrytëzuar:

- Çabej, Eqrem,** *Studime gjuhësore III*, Rilindja, Prishtinë, 1976.
- Demiraj, Shaban,** *Gjuhësi ballkanike*, Logos – A, Shkup, 1994.
- Demiraj, Shaban,** *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*, SHB “Shkenca”Tiranë, 1999.
- Demiraj, Shaban,** *GJUHA SHQIPE – Probleme dhe disa figura të shquara të saj*, Globus R, Tiranë, 2003.
- Dhrimo, Ali,** *Norbert Jokli – më i shquari albanolog austriak (1877 – 1942)*, Gjuha jonë 3-4, 1992, f. 86 – 94.
- Jokli, Norbert,** *Naim Frashëri dhe pasurimi i gjuhës shqipe*, Gjuhë jonë 3-4, 2000, f. 34 – 46.
- Ramadani, Fehari,** *Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare 1900 – 1912*, Tetovë, 2010.
- Katicic, Radoslav,** *Ancient languages of the Balkans*, Paris, 1976.
- Kurti, P. Donat,** O.F.M. 1935, *Vepra kulturale e elementit katolik në Shqypni*, Shkodër, Botimi i “Hyllit të Dritës”.
- Vishko, Ali,** *Kongreset e alfabetit dhe të shkollës shqipe*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1992.
- Koliqi, Hadrulla,** *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, SHBLSH, Prishtinë, 2002.

¹ Për më tepër shih: Historia e Popullit Shqiptar II..., 2002, f. 254; Ali Vishko, Kongreset e Alfabetit dhe të Shkollës Shqipe, Shkup, 1992, f. 132; H. Koliqi, Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar, f. 183.

² AIH, Vj. 10-1-102. Raport i konsullatës austro-hungaraze në Manastir drejtuar Vjenës, më 14 janar 1902, (ku përfshihej edhe një Shkresë-falënderimi që Gjergj Qiriazi i dërgonte qeverisë austro-hungareze, nga Korça, më 20 nëntor 1901).